



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:106142

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05521558

KF.nr.118/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ të paditësit “Agro-Kuka” Sh.P.K., me numër fiskal 601037139 dhe seli në fshatin Vrellë në Istog, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi nr.97/2020 i datës 29.07.2020 i ATK-së, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 14.03.2024 në prani të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit “Agro-Kuka” Sh.P.K., me seli në fshatin Vrellë në Istog, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.97/2020, i datës 29.07.2020, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi “Agro-Kuka” Sh.P.K., me seli në fshatin Vrellë në Istog, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 01.09.2020, ka iniciuar kontest tregtar-administrativ kundër vendimit nr.97/2020 i datës 29.07.2020 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor-kryesor dhe në fjalën përfundimtare pala paditëse ka deklaruar se qëndron pranë padisë dhe kërkesëpadisë të cilën e ka parashtruar ndaj ATK-së, sipas mendimit të tij i është dukur se janë ngarkuar në një masë mjetesh padrejtësisht nga e paditura ashtu që janë kanë ngarkuar me shumën të cilën e kontestojnë në tërësi. Ka theksuar se arsyeja e padisë është

kundërshtimi i shumës së caktuar në raportin e kontrollit nga e paditura. Gjykatës i ka propozuar që pas shqyrtimit të provave të administruara të marrë aktgjykim me të cilin do të anulohet aktvendimi nr.97/2020 dhe të lirohet nga ngarkimi tatimor dhe gjoba e shqiptuar me njoftim shtesë sipas njoftimit për rivlerësim. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 22.07.2021, e konteston padinë e paditësit si të pa bazuar dhe konsideron se vendimi i DA/ATK-së, si palë e paditur në këtë konflikt administrativ është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Ka theksuar se DA ka vërtetuar se kontrolli është kryer bazuar në provat dhe dëshmitë që i ka dorëzuar paditësi, librat e shit/blerjes, në pajtim me Ligjin nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 19.2 dhe 2.1 si dhe neni 29 i Udhëzimit administrativ 15/2010, për zbatimin e këtij ligji. Ka shtuar se paditësi nuk ka përdorur koeficientet e akreditimit sipas ligjit dhe lidhur me ngarkesën e kundërt nuk ka vepruar sipas ligjit, kontrolli i zhvilluar nga ATK ka bërë korrigjimin e koeficienteve dhe ngarkesës së kundërt. E paditura, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 14.03.2024, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe ka pranuar ftesën për këtë seancë, nuk ka prezantuar duke e njoftuar Gjykatën me parashtrësën e datës 07.03.2024, se nuk do prezantoj në seancë dhe njëherit ka kërkuar nga Gjykata të veprohet në pajtim me nenin 38, par 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrativë, andaj Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, e ka proceduar çështjen duke i lexuar parashtrësat e të paditurës. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padia e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi nr.97/2020 i datës 29.07.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 14.03.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi kontestues nr.97/2020 datës 29.07.2020, Aneksi 1 i kontratës mbi ndërtimin e përbashkët LRP.nr.4895/2019 datës 08.10.2019, Vendimi i ZGJONA nr. 015/2020 datës 31.01.2020, Librat e shitjeve për periudhat: 01.01.2018-31.12.2018; 01.01.2019-31.12.2019; 01.01.2017-31.12.2017, Librat e blerjeve për periudhat: 01.01.2014-31.12.2014; 01.01.2015-31.12.2015; 01.01.2016-31.12.2016 dhe Raporti i kontrollit me nr.9471.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe

arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave i ATK-së, e ka refuzuar ankesën e subjektit në procedurë, duke konstatuar se gjatë kontrollit ka analizuar blerjet, shitjet, shpenzimet për secilën periudhë tatimore, llogaritë bankare, stoqet. Ka analizuar llogaritë në Pro Credit Bank dhe faturat e blerjes si dhe librat e shitjes. Tatimpaguesi nuk ka mbajtur librat dhe regjistrimet konform ligjeve në fuqi, pasi që tatimpaguesi është në cilësinë e Investitorit duke investuar në objekte afariste banesore, i njëjti nuk ka përdorur koeficientin e kreditimit sipas ligjit, nuk ka vepruar sipas ligjit të ngarkesa e kundërt, por me kontroll ka bërë korrigjimin e koeficienteve dhe ngarkesës së kundërt.

Ndërsa sa i përket kontestit të paditësit se nuk është bërë një vlerësim i drejtë përkatësisht është bërë një vlerësim i njëanshmen, gjykata e vlerëson si të pa bazuar këtë pretendim për arsye se e paditura vendimin e vetë nr.97/2020 e ka mbështetur në provat materiale të dorëzuara nga tatimpaguesi, respektivisht nga librat dhe regjistrimet përkatëse të tatimpaguesit bazuar në nenin 19, paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe nenit 29 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr.03/L-222. Divizioni i Ankesave pas analizimit të vlerësimit të kontrollit ka vendosur se tatimi shtesë ka ardhur si rezultat i ndryshimit të Koeficientit të Kreditimit të TVSH-së. Ngarkesa e kundërt e TVSH-së, mos raportimi i shitjes sipas të gjeturave nga analizimi i ekstrakteve bankare dhe mos deklarimi i tatimeve sipas dispozitave ligjore për kontrata ndërtimore afatgjate nga tatimpaguesi. Divizioni i Ankesave ka vendosur se vlerësimi sipas Koeficientit të Kreditimit është bazuar në nenin 39 të Ligjit nr.03/L-146 përkatësisht nr.05/L-037 për Tatim mbi Vlerën e Shtuar, Vendimin Shpjegues Publik nr.01/2014, vlerësimi sipas Ngarkesës së Kundërt në shërbime ndërtimore është bërë sipas nenit 52 paragrafi 1.4, nënparagrafi 1.4.1 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSh, nenin 69 të Udhëzimit Administrativ nr.03/2015 për zbatimin e Ligjit nr. 05/L-037, VSHP nr.01/2016, ndryshimet e shitjeve sipas ekstrakteve bankare janë në përputhje me nenin 19, paragrafi 2, nën paragrafin 2.2 dhe nenin 15 të Ligjit nr.03/L-222 për Vlerësimet Tatimore dhe Procedurat, dhe po ashtu nga regjistrimet e tatimpaguesit janë vlerësuar mos raportim i saktë i të ardhurave sipas dispozitave të Ligjit nr.05/L-029 neni 5 paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 i Ligjit nr.05/L-029 për të ardhurat Korporatave, neni 8 i Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 për zbatimin e Ligjit nr.05/L-029.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështrim të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t'i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuara nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Tutje Gjykata vlerëson se nuk është i bazuar as pretendimi ankimor se paditësit fare nuk i është dhënë mundësia ta shfrytëzoj të drejtën për tu dëgjuar dhe për t'i theksuar argumentet e tij kundër vendimit të shkallës së parë, kjo për faktin se nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi nuk ka parashtruar kërkesë për seancë dëgjimore ashtu siç është përcaktuar me nenin 44 paragrafi 34 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 për Zbatimin e Ligjit nr.03L-222 me të cilin përcaktohet se *“DA mund të vendosë mbi ankesën bazuar në faktet e prezantuara dhe nëse nuk ka kërkesë për seancë dëgjimore nga tatimpaguesi, shqyrtimi mund të vazhdojë pa mbajtje të seancës dëgjimore. Shqyrtimi i ankesës nga DA do të bëhet duke pasur parasysh dëshminë e parashtruar apo të siguruar për DA dhe pa mbajtje të seancës dëgjimore”*.

Rrjedhimisht, gjykata i vlerësoi si të pabazuar pretendimin e paditësit se aktvendimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të dispozitave procedurale, gjendja faktike është konstatuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plot dhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht, prandaj si i tillë kërkon që të anulohet, përveç të theksuar në padi si të tillë nuk e ka argumentuar me asnjë provë të vetme materiale këtë pretendim e që sipas nenit 7, paragrafi 1 dhe 3, i Ligjit për Procedurën Kontestimore nr. 03/L-006 parasheh se: *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Po ashtu edhe sipas nenit 38, par 2, të LKA-se Gjykata vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pala paditëse duhet të parashtrtoj faktet, në të cilat mbështetet kërkesa e saj, e si rrjedhojë e kësaj kuptohet se përgjegjësia e sjelljes së fakteve dhe provave është barrë e vetë palëve të përfshira në procesin gjyqësor.

Konform nenit 43, paragrafi 1 të LKA-së, Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të. Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.118/22 datë 14.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.